



ОПШТИНА РАНИЛУГ - КОМУНА Е РАНИЛУГУТ
ПРИЈЕМНА КАНЦЕЛАРИЈА ЗУРА Е ПРАНИМИТ

Org. jed./Nj. org./Org. unit O.R.
Br. s./Nr.f./No.p./ 02-016/2022
Datum/Data/Date 31.01.2022

ОПШТИНА РАНИЛУГ - КОМУНА Е РАНИЛУГУТ

Republika Kosovo
Republika e Kosoves
Republic of Kosovo

Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranilug



RREGULLORE MBI GRUPIN JOFORMAL TË GRAVE TË KOMUNËS SË RANILLUGUT

Ranillug
JANAR 2022

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Neni 15, paragrafi 15.1 i Statutit të Komunës së Ranillugut nr. 02-154/2011, Ligji për barazi gjinore Nr. 05/L-040 020, Kuvendi i Komunës së Ranillugut në seancën e parë të rregullt të mbajtur më 31.01.2022 ka miratuar:

RREGULLORE PËR GRUPIN JOFORMAL TË GRAVE NË KOMUNËN E RANILLUGUT

Neni 1.

1.1. Kjo rregullore përcakton punën dhe funksionimin e grupit joformal të grave në komunën e Ranillugut.

1.2. Grupi joformal i komunës së Ranillugut vepron pa marrë parasysh dallimet politike, fetare apo etnike.

1.3. Është krijuar një grup joformal i grave për të forcuar profilin gjithëpërfshirës të grave, për të hapur dhe paraqitur çështje dhe me interes për to me qëllim të arritjes së statusit të barabartë të qytetarëve në nivel komunal. Në këtë kontekst, grupi do të synojë të lehtësojë dhe koordinojë aktivitetet e Zyrës për Barazi Gjinore, duke përfshirë Njësinë për të Drejtat e Njeriut, si dhe të inicojë aktivitete bazuar në problemet, nevojat dhe çështjet me interes për qytetarët dhe qytetaret e komunës së Ranillugut.

1.4. Grupi joformal i grave është një organ apolitik që vepron në bazë të reputacionit dhe vullnetit të mirë, me qëllim të forcimit të pjesëmarrjes së gruas në të gjitha sferat e jetës publike dhe politike.

Neni 2.

Veprimet e grupit joformal të grave

2.1. Grupi joformal i grave merret me çështjet e barazisë gjinore, promovimin e të drejtave të grave dhe afirmimin e tyre social, si dhe fuqizimin e përgjithshëm të grave në të gjitha sferat e jetës.

2.2. Zhvillon një plan veprimi vjetor në të cilin janë parashikuar të gjitha aktivitetet.

2.3. Ndhmon Zyrën për Barazi Gjinore në hartimin e rregulloreve komunale në përputhje me kornizën ekzistuese ligjore për barazi gjinore.

2.4. Ai mbështet bashkëpunimin ndërmjet shoqërisë civile, sektorit privat dhe publik, duke u marrë me çështje të ndryshme me interes të grave, me institucionet përkatëse komunale.

2.5. Ndhmon në planifikimin dhe vlerësimin e nevojave lidhur me rritjen e respektit për barazinë gjinore në komunë.

2.6. Shqyrton propozimet dhe koordinon planet e nivelit qendror dhe lokal për aktivitetet e barazisë gjinore.

2.7. Propozon programe dhe projekte për autoritetet vendore dhe qendrore lidhur me aktivitetet e grupit të grave dhe Zyrës për Barazi Gjinore.

2.8. Ai mbështet kremtimin e festave të brendshme dhe ndërkombëtare në lidhje me çështjet dhe të drejtat e grave. Si pjesë e kësaj, propozon masa adekuate për zbatimin e programeve shëndetësore, arsimore, kulturore dhe pedagogjike lidhur me respektimin e barazisë gjinore.

2.9. Përcjellë zhvillimet në nivel ndërkombëtar lidhur me çështjet gjinore.

2.10. Realizon dhe zbaton detyra dhe përgjegjësi të tjera në bazë të nevojave.

Neni 3.

Përbërja e grupit joformal të grave

Grup joformal i grave përbëhet nga gra të jetës publike dhe politike. Të gjitha gratë anëtare të K.K-al janë automatikisht anëtare të grupit të grave. Një pjesë shtesë ose një pjesë tjetër e grupit të grave përbëhet nga gratë nëpunëse civile të administratës komunale. Më poshtë është përbërja e grupit joformal të grave:

1. Milka Gjokiq, Zyrtare për Marrëdhënie me Publikun, kryetare e grupit
2. Snezhana Ristiç, këshilltare e Kuvendit Komunal të Ranillugut, nënkryetare e grupit.
3. Marina Marković Cuckiq, Shefe e Burimeve Njerëzore, anëtare e grupit
4. Sunçica Andrejeviç, këshilltare e Kuvendit Komunal të Ranillugut, anëtare e grupit.
5. Milica Filipović, këshilltare e Kuvendit Komunal të Ranillugut, anëtare e grupit.
6. Violeta Vasiç, këshilltare e Kuvendit Komunal të Ranillugut, anëtare e grupit.
7. Milena Artonović, këshilltare i komunës së Ranillugut, anëtar i grupit
8. Ana Nasković, këshilltare e Kuvendit Komunal të Ranillugut, anëtare e grupit
9. Katarina Ristiç Iliç, kryetare komune, anëtare e grupit
10. Sunçica Jaçimović, kryetare e Kuvendit Komunal të Ranillugut, anëtare e grupit.
11. Zorica Dimitrijeviç, këshilltare e Kuvendit Komunal të Ranillugut, anëtare e grupit.
12. Zorica Mladenović, asistente e kryetarit të komunës, anëtare e grupit
13. Violeta Nikoliç, Zyrtare për Kthim dhe Komunitete, anëtare e grupit
14. Javorika Simić Tasiç, senior menaxhere për çështjet e shërbimeve amë, anëtare e grupit
15. Miljana Maksimović, Zyrtare për Çështje Ligjore në Departamentin e Kadastrës dhe Gjeodezisë, anëtare e grupit.
16. Vesna Mitković, Zyrtare e pranimit dhe marrëdhënies me publikun, anëtare e grupit
17. Verica Mikiç, higjieniste, anëtare e grupit
18. Biljana Stojanović, higjieniste, anëtare e grupit

19. Maja Antiq Milanoviq, nëpunëse në departamentin e kadastrës dhe gjeodezisë, anëtare e grupit.
20. Bojana Jevtiq, zyrtare bujqësore në departamentin e bujqësisë, anëtare e grupit.
21. Zorica Natiq, Zyrtare për Barazi Gjinore, anëtare e grupit
22. Danijela Todoroviq, nëpunëse pronësie, anëtare e grupit
23. Jasmina Kitanoviq, zyrtare ligjore, anëtare e grupit
24. Aleksandra Nikoliq, zyrtare për kulturë, anëtare e grupit
25. Violeta Millosheviq, shofer i kryetarit, anëtar i grupit

Neni 4.

Organizimi i grupit joformal të grave

4.1. Grupi joformal i grave zgjedh këshillin (bordin drejtues), kryetarin dhe nënkryetarin duke votuar në asamblenë themeluese ose në mbledhjen e rizgjedhjes së kryesisë. Zgjedhja ose rizgjedhja bëhet me shumicë të thjeshtë të grupit. anëtarët e pranishëm.

Asambleja themeluese e grupit joformal të grave zgjodhi një bord drejtues të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Milka Gjokiq, Kryetare e Bordit
2. Snezhana Risti, Zëvendëse Bordi
3. Marina Cuckiq Markoviq anëtare e Bordit
4. Sunçica Andrejeviq, anëtare e Bordit
5. Milena Aritonovic, anëtare e Bordit
6. Maja Milanoviq Antiq, anëtare e Bordit
7. Javorka Simić Tasiq, anëtare dhe arkëtare e Bordit

Neni 5.

5.1. Mandati i kryetares të zgjedhur dhe zëvendëseve të saja zgjat 3 (tre) vite.

5.2. Këshilli ose Bordi Drejtues propozon dhe zgjedh anëtarët e grupit joformal në një mbledhje me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të grupit. Këshilli ose Bordi Drejtues mund të ketë 5 ose 7 anëtarë Kryesuesja e grupit joformal të grave është ex officio në Këshill/Bordin e Drejtues.

5.3. Kryetarja dhe zëvendësja e grupit joformal të grave zgjidhen në bazë të propozimeve të anëtarëve të grupit. Nëse ka vetëm një kandidat për kryetar të grupit, atëherë propozimi shqyrtohet me shumicë votash në listën e hapur. Nëse ka më shumë se një kandidat, kryetarja dhe zëvendëskryetarja zgjidhen me votim të fshehtë.

5.4 Në rast ndërrimit të kryetares të grupit ndërrohen automatikisht zëvendëset, të cilët zgjidhen njëjloj si kryesuesja.

Neni 6.

Takimet e grupit joformal të grave

6.1. Grupi joformal i grave do të mbledhet një herë në muaj, ndërsa Komiteti Drejtues do të takohet sipas nevojës. Mbledhjet e bordit drejtues thirren dhe udhëhiqen nga kryesuesja e kishillit, por në rast të mungesës së arsyetuar, është zëvendësuesja e saj. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili miratohet nga kryesuesja e grupit.

6.2. Zyrtarja e Barazisë gjinore duhet të jetë prezente në të gjitha takimet e grupit dhe të Komitetit Drejtues. Në rast se nuk mundë të merr pjesë, ajo duhet të caktojë një person që ta përfaqësojë gjatë një takimi të caktuar.

6.3. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve duhet të marrin pjesë rregullisht në mbledhje dhe çdo mungesë duhet t'i raportohet Kryesueses ose zëvendësuesve të saj. Anëtari që nuk merr pjesë në tri mbledhje të rregullta radhazi pushohet dhe emërohet një anëtar i ri.

Neni 7.

Rendi i ditës i takimeve

7.1. Kryesuesja propozon rendin e ditës në bashkëpunim me anëtarët e Bordit Drejtues.

7.2. Pikat e rendit të ditës për të cilat është rënë dakord me konsensus duhet të diskutohen në mbledhjen e ardhshme, dhe kryesuesi duhet të konsultohet me anëtarët ose të bjerë dakord për pikat e rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme të rregullt ose të jashtëzakonshme.

7.3. Kryesuesja e grupit të grave është përgjegjëse për kryesimin e mbledhjeve. Anëtarët e grupit janë të detyruar të respektojnë rregullat e punës dhe detyrat e kryesueses.

7.6. Kryesuesja mund të largojë dikë nga mbledhja në rast të mosrespektimit të rregullave ose në kundërshtim me udhëzimet e kryesueses.

Neni 8.

Marrja e vendimeve

8.1 Grupi joformal i grave nuk është organ që merr vendime ekzekutive në institucione, por mund të dërgojë propozime në Zyrën për Barazi Gjinore të Kuvendit të Komunës me sqarime të caktuara nëse është kërkesë apo nevojë për ndonjë akcion apo veprim.

8.2 Nëse kërkohet votim, vendimi merret me konsensus të të gjithë anëtarëve të grupit dhe nëse kjo nuk mund të arrihet për arsye të caktuara, vendimi mund të merret me shumicë të thjeshtë të pranishëm në mbledhje.

8.3. Votimi bëhet duke ngritur dorën sipas parimit: “për” – “kundër” – dhe “abstenim”. Në rast të numrit të barabartë të votave, kryetari ka një votë shtesë që do të vendosë pro ose kundër propozimit.

Neni 9.

Renditja finale dhe e përkohshme e përgjegjësi

9.1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje është përgjegjës grupi joformal i grave nga komuna e Ranillugut.

9.2. Kryesuesja e grupit joformal të grave vazhdimisht shqyrton Rregulloren e Punës dhe herë pas here mund të propozojë ndryshime në dokument nëse ka arsye të vlefshme për ta bërë këtë.

Neni 10.

Nxjerrja jashtë fuqisë

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Rregullorja për Punën e Iniciativës së Grave nr. 02-047/2019, datë 25.03.2019 nxirret nga fuqia.

Neni 11.

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit në seancën e Kuvendit të Komunës së Ranillugut.


Datë: 31.01.2022

Ranilug

Përktheu: Lazim Bajrami



Kryesues i K.K të Ranillugut


Ivan Krstiq